



Universität  
Basel

# Historia etimologjike e fjalës *liqen-i* huazuar nga greqishtja; zhvillimet e tingujve, analogjia dhe trajta inekzistente

Gerard Spaans (Universiteti i Bazelit), [gerard.spaans@unibas.ch](mailto:gerard.spaans@unibas.ch)  
30 janar 2024



Schweizerischer  
Nationalfonds



The Albanian Language  
in Antiquity

# Përmbajtja

– Fjala *liqen*:

– në shqipen moderne

– në literaturën etimologjike

– në letërsinë dhe fjalorët e hershëm

– në Fjalorin Etimologjik të Gjuhës Shqipe të Gustav Meyerit (1891)

– Përfundimet

# Shqipja moderne

- *liqen-i* (m.): [li'cɛn], [li'c̣ɛn], [li'tʃɛn]
- Në jug të Shqipërisë, përdoret edhe fjala *gjol(l)-i* (m.) 'liqen'

	NJ		SH	
	PASHQ	SHQ	PASHQ	SHQ
<b>EMË</b>	liqen	liqen-i	liqen-e	liqen-et
<b>KALL</b>		liqen-in		
<b>GJIN</b> e/i	liqen-i	liqen-it	liqen-eve	liqen-eve
<b>DHAN</b>				
<b>RRJE</b>			liqen-esh	

# Literatura etimologjike

- Schuchardt (1867: 490): < lat. *lacuna* ‘zgavër, pellg’
- Miklosich (1871: 34): < lat. *lacus* ‘liqen’
- Meyer (1891: 234):
  - përzierje e lat. *lacuna* + *lagoena* ‘enë verë’
  - ai përmend dy trajta të tjera: geg. *liqenë* (f.), tosk. *lëqyer* (m.)
- Thumb (1909: 15):
  - *liqenë* (f.) < greq. e vjetër λεκάνη ‘legen’
  - *liqē-ni* (m.) < greq. e vjetër λεκάνιον ‘legen i vogël’
- Jokl (1915: 34):
  - *liqenë* (f.) < greq. e vjetër λεκάνιον
  - *lëqē* “emërore e re” bazohet në interpretimin e formës *liqe-në* si një trajtë në KALL.NJ.SHQ.M
- Çabej (1976-2014, V: 238): < greq. e vjetër λεκάνιον
- Ölberg (1972: 42): < greq. e vjetër λεκάνη, λεκάνιον; ndryshimi ‘legen’ > ‘liqen’ ka ndodhur në shqip
- Fjala *liqen* nuk është në Orël (1998)
- Topalli (2017: 894):
  - *liqen* < greq. e vjetër λεκάνη
  - prapa-formim i trajtës *liqé-ni* (interpretuar si *liqén-î*); shumësi i singularizuar për të shpjeguar zanoren -e-.

# Literatura etimologjike


- Disa shënime të shkurtra për parahistorinë e fjalës *liqen*:
  - Përmenden dy burime të mundshme: *λεκάνη* (*lekánē*) ‘legen’ dhe *λεκάνιον* (*lekánion*) ‘legen i vogël’,
  - Të dyja janë të mundshme, fonologjikisht.
  - Trajta *λεκάνη* (*lekáni*) ekziston ende në greq. moderne dhe ka marrë një kuptim gjeografik ‘det, liqen, pellg’,
    - P.sh. *Λεκάνη της Μεσογείου* ‘Deti Mesdhe’
  - Pape (1842: 17):
    - Fjala *λεκάνιον* është përdorur nga Aristofani dhe Ksenofoni (në shekujt V-IV p.e.s.).
    - Një trajtë e re zvogëluese *λεκανίδιον* (*lekaníðion*) është përdorur nga p.sh. Jul Polluksi (në shekulli II).
- Përfundimi: *λεκάνη* është burimi më i llogjikshëm, por nuk vjen nga greqishtja e vjetër, sepse në atë kohë fjala nuk kishte ende kuptimin ‘det, liqen, pellg’.
- Propozim: fjala *liqen* buron nga greqishtja e hershme mesjetare *λεκάνη* (*lekáni*) ‘det, liqen, pellg’, huazuar para umlautit dhe palatalizimeve të shqipes rreth shekullit VIII.
- Rezultati: fjala është huazuar para ndarjes së toskërishtes dhe gegërishtes (në shekujt VIII-XI).
- Me pak fjalë: në një moment të historisë së hershme, para umlautit dhe palatalizimeve (*\*lekáni* > *\*leqéni*), kjo fjalë është ri-analizuar si një trajtë NJ.SHQ.M *\*leqén-i*, në bazë të së cilës u formua një trajtë e pashquar e re *\*leqén*. Kjo trajtë më vonë humbi *\*-n*, zanorja u zgjat dhe zanoret e patheksuara u dobësuan: *\*leqén* > *lëqē*.

# Dëshmitë e hershme

- Buzuku (1555): ‘gropë (e luanëve)’  
*qi liberoi Danielë ën liqenit së luanjet.* (fol. 60v)  
‘që e shpëtoi Danielin prej gropës së luanëve.’
- Budi (1618):  
*posikūr një lëqē plot me akullë* (DC 144.6)  
‘si një liqen plot me akull’
- Bardhi (1635: 45):  
*Lacus – Lekiee* (në drejtshkrimin modern: *lëqē*)
- Bogdani (1685):  
*gjithë ujetë ndë lëqē* (Intr. xxix.)  
‘gjithë ujin në liqen’

# Fjalorët e hershëm

– Keta (1763) (Fjalor italisht-arbërisht):



**Lago** Ilekieni m. Ilekéja f. (në drejtshkrimin modern: *leqèni, leqéja*)

– Xylander (1835: 241):

(λεκιέκ), liqen, m.

-> lexo: (*Ileqèk*); A e ka lexuar ai trajtën e Nikollë Ketës si <Ilekièki>? E dyshimtë!

– Von Hahn (1854: 59):

(λεκjëκ), λεκjëν-ι, geg., liqeni -> lexo: (*Ileqèk*), *leqén-i*

# Fjalorët e hershëm

– Kristoforidhi (1868-1879): Përkthimet e psalmeve dhe të testamentit të ri në gegërisht dhe toskërisht.

## Psalm 114:8

G *i cilli bāni gurinë **lēgene** ujënash, edhe shkrepin' e shkambit bunime ujënash.*

T *i cili bëri gurrë **liqere** ujërash, edhe shkrepn' e shkëmbit burime ujërash.*

'ai e ktheu shkëmbin **në liqen**, shkrepin në burime ujërash.' (Biblia Shqip "së bashku", 2020)

## Luka 8:23

G *Edhe ata tue lundruem, e muer gjumi, edhe sdripi nji thëllim ere **ndë lëqent** ...*

T *Edhe ata tek ishinë dyke lundruarë, e zuri gjumi. Edhe sbriti një thëllim ere **ndë lëqert** ...*

'Ndërsa po lundronin, Jezuin e zuri gjumi. Papritur filloi një erë e fortë **mbi liqen**.' (BS "së bashku", 2020)

– Kristoforidhi (1904: 202): Geg *liqé-ni*, PL *liqénj-të*  
Tosk *lëqé-ri*, PL *lëqénj-të*



# Fjalorët e hershëm

- Dozon (1879):
- Burimi I punës së tij: Kristoforidhi
- Qartësisht ka plot gabime:
  - <li> në vend të <ly> (<l> nuk ekziston në drejtshkrimi e tij!)
  - <k> në vend të <ky> (krasaho <kyéni> për *qeni*)
  - <e> në vend të <œ> për ë
  - Theksi në rrokjen e parë
- Trajta e pritshme pas drejtshkrimit të tij: <lyœkyér>
- Weigand (1914: 161):
- See [‘liqen’] m. *gjoll-i*; N *liqé-ni*

*Lyéh, lyé, aboyer : lyéou kyèni, le chien a aboyé. — Cf. sb. layati. Lyéhortæ, V. lyétæ. Lyehònæ, accouchée; lyehonî-a, les couches. — gr. λέχος. Lièker, pl. e, Kr., lac. Lyekoînt, secouer, balancer. Lyekoîræ, peau, cuir, outre ;*

# Trajtat e çuditshme të Meyerit

– Fjalor etimologjik (1891: 234):

“Më në fund geg. *l'éké-ni*, tosk. *l'ékér*, *l'éküer* m. `liqen', geg. *l'ikenε* f. `liqen, pellg' Krist.;"

– Vëzhgime:

– Për gegërishtën, ai përmend trajtën e pashquar *lëqé* ‘liqen’, dhe trajtën e shquar *lëqéni* ‘liqeni’.

– Për toskërishtën, ai përmend trajtën e pashquar *lëqér* ‘liqen’, dhe një trajtë të papërcaktuar *lëqyer*.

– Ai përmend edhe një trajtë shtesë gegërisht *liqenë* (konsideruar seriozisht nga Thumbi, Jokli, Çabej, Ölbergu).

– Pyetje:

– Çfarë përfaqëson trajta *lëqyer*?

– Ku e gjeti Meyer një trajtë femërorë *liqenë* në gegërisht?

– Metodologjia:

– Ndjekja e burimeve.


– Në këtë rast: “Krist.” duhet t’i referohet Kristoforidhit, por në cilën nga veprat e tij të shumta dhe në cilën faqe konstatohet kjo referencë?

– Një mjet tjetër i mundshëm: botimet të tjera të Meyerit.

# Trajta *liqenë* e Gustav Meyerit (1)

- Konstatime etimologjike për emrat në shqipes (1883: 304):
  - *lëqena* Krist. Alf. g. 21
  - *lëqere* Krist. Alf. t. 22
- Ide: ndërsa shkruante Fjalorin Etimologjik në 1891, Meyer i interpretoi komentet e tij të vitit 1883 si më poshtë:
  - Gegërisht: *lëqenë*, PL *lëqena* (krahaso NJ *vajzë*, SH *vajza*) -> femërore!
  - Toskërisht: *lëqer*, PL *lëqere* -> mashkullore!
- *Abetār Škip* (Kristoforidhi 1872):
  - Faqe 21: asnjë fjalë për ‘liqen’
  - Bibliografi e Meyerit (1883: 264): *Abetār*-i ka 30 faqe.
  - Në realitet: 32 faqe.
  - Në dy faqet e para gjendet vetëm alfabeti i shqipes. Ndoshta Meyer i ka neglizhuar këto faqe?
  - Në këtë rast, faqja 21 e Meyerit duhet të korrespondojë me faqen 23.
  - Çfarë gjejmë në faqen 23?

# Trajta *liqenë* e Gustav Meyerit (1)



– Në drejtshkrimin modern:

*Peshku. Peshqitë rrojënë mbrenda nd' ujë, do me thënë, ndëpër dētet, e ndëpër kënetat [lëqenat], e ndëpër lumnat.*  
'Peshku. Peshqit rrojnë brenda në ujë, do me thanë, nëpër detet, e nëpër kënetat [lëqenet], dhe nëpër lumenjtë.'

– Vëzhgime:

- Fjala është midis kllapave, kështu që ndoshta nuk ishte pjesë e mendimeve fillestare të Kristoforidhit.
- Fjala është midis dy fjalëve të tjera për ujë, trajta shumës e të cilave formohet me *-at*.

– Përfundimi: këtë trajtë ndoshta është ndikuar nga *kënetat* dhe *lumnat*.

# Trajta *liqenë* e Gustav Meyerit (2)

– Megjithatë, ky nuk është burimi i vetëm i mundshëm për trajtën *liqenë* të Meyerit.

## Psalm 107:35

G *Băn shkretinënë lëqenë ujënash, edhe dhën' e thatë vruime ujënash.*

T *Bën shkretëtirënë liqere ujërash, edhe dhen' e thatë, burime ujërash.*

‘Shkretëtirën e shndërroi në liqen, tokën e thatë në burime ujërash.’ (Biblia Shqip “së bashku”, 2020)

– Vëzhgime:

– Një trajtë geg. me -ë pranë një trajtë tosk. me -e.

– Trajta *lëqenë* mund të analizohej si më poshtë:

– SH.PASHQ i *lëqen* (krahaso NJ *punëtor*, SH *punëtorë*).

– NJ.SHQ i *lëqe*. Por: përkthimi ‘shkretëtirën e shndërroi në liqenin’ nuk ka kuptim.


– NJ.PASHQ femërore ‘një liqen’. Përkthimi në gegërisht: ‘shkretëtirën e shndërroi në liqen’.

– Kristoforidhi ka gabuar dhe duhej të shkruante *lëqene*, ashtu si tek Psalmi 114:8 (shih faqjen 7).

– Përfundimi: Ndoshta *lëqenë* është një gabim (duhet të ishte *lëqene*), por Meyer e mori trajtën tepër seriozisht.

33 Băn lūmēnatę tę škretę, eđe vruimeł e ūyēnavet tę θatę.  
34 Δēnę ki bān rōmę, tę ngēłmētę, pęr tę keken' e atŭneve ki  
35 rinę nd' atę. Bān škretinęnę **lęqenę** ūyęnaš, eđe đēn' e θatę  
36 vruime ūyęnaš. Eđe atię vę tę rinę tę ūnęšimite, eđe ngręfinę  
37 kŭtete pęr tę ndęđunę: eđe mbielin' āra, e vęnę vęneštę, eđe

# Trajta *liqenë* e Gustav Meyerit



33 Bān lūmenatę tę škretę, eðe vruimeł e ũyęnavet tę θatę.  
34 Δēnę ki bān rōmę, tę ngēłmętę, pęr tę keken' e atŭneve ki  
35 rineę nd' atę. Bān škretŭneę **lękeneę** ũyęnaš, eðe ðēn' e θatę  
36 vruime ũyęnaš. Eðe atiē vę tę rineę tę ũnešimateę, eðe ngręfineę  
37 kŭtete pęr tę ndęŭunę: eðe mbielin' āra, e vęnę vęneštę, eðe

- Një problem për të dyja hipotezat:
  - Trajtat e dëshmuara tregojnë për *lëqenë* dhe jo *liqenë*.
  - Zgjidhja e mundshme: Fjalori i Kristoforidhit (1904) u botua pas vdekjes së autorit. Ndoshta Meyer ka qenë në kontakt me Kristoforidhin ose ai ka parë një version më të hershëm, në bazë të së cilit ai ka “korrigjuar” trajtën në *liqenë*.
- Përfundimi:
  - Nuk dihet plotësisht se ku shfaqet fjala *liqenë* në veprat e Kristoforidhit.
  - Meyer duhet të ketë gabuar diku në analizimin e veprave të Kristoforidhit diku.
  - Trajta *liqenë* duhet të jetë një “fjalë inekzistente” (dmth: trajta nuk ka ekzistuar kurrë).

# Trajta *lëqyer* e Gustav Meyerit

- Trajta tjetër e çuditshme e Meyerit: toskërisht *lëqyer*.  
(1891: 234): “Më në fund geg. *l'éké-ni*, tosk. *l'ékér*, ***l'éküer*** m. `liqen', geg. *l'íkene* f. `liqen, pellg' Krist.;"
- Disa mendime fillestare:
  - Nëse jepet një trajtë NJ.SHQ e geg. *lëqé (lëqéni)*, atëherë ndoshta *lëqyer* përfaqëson trajtën tosk. NJ.SHQ?
    - Me shumë mundësi jo. Ky formim i trajtave të shquara nuk ekziston në shqip.
  - A është një SH.PASHQ i *lëqér*?
    - Një model i mundshëm: NJ *dérë*, SH *dyer* >> NJ *lëqér*, SH *lëqyer*?
    - Ndoshta jo, ai duhet të kishte specifikuar “SH” në krahasim me trajtat gegërisht.
  - Një trajtë alternative e *lëqér*-it, dmth: *lëqyer* përfaqëson edhe një trajtë NJ.PASHQ?
  - Dëshmia e vetme, pra a është gabim?
- Metodologjia:
  - Ndjekja e burimeve!
  - Burimet e tij kryesore (Meyer 1891: VII):
    - Von Hahn (1854) -> gegërisht
    - Dozon (1879) -> toskërisht -> Këtu duhet të përqendrohemi!

# Trajta *lëqyer* e Gustav Meyerit

- Meyer (1891: 234): *l'ékér*, *l'éküer*
- Meyer (1883: 304): “tosk. *l'ékér* (në Dozon gabimisht *lièker*)”

- Pra, ai ishte i vetëdijshëm për gabimin e Dozonit në 1883!
- Kujtesë: Dozon duhej të kishte shkruar <lyœkyér>

- Ide:
  - Meyer e rindërtoi këtë, ashtu sikurse unë.
  - Ose: Dozon dërgoi një korigjim që mbërriti tek Meyer.
  - Meyer shkroi diçka si <lyœkyer> në kopjen e tij të Dozon (midis 1879 dhe 1883).
  - Në 1891, ai kopjoi gabimisht <Lièker, Lyœkyer> si “*lëqér, lëqyer*”.

- Ky është vetëm një rindërtim i bazuar në literaturën e marrë në konsideratë. Skenarë/detaje të tjera janë të mundshme!

- Përfundimi:
  - Ka shumë të ngjarë që Meyer të ketë bërë një gabim në interpretimin e trajtës së gabuar të Dozonit.
  - Me fjalë të tjera: *lëqyer* është ndoshta një trajtë që në fakt nuk ka ekzistuar kurrë.

*Lyéh, lyé, aboyer : lyéou kyèni, le chien a aboyé. — Cf. sb. layati. Lyéharta, V. lyéta. Lyehónæ, accouchée; lyehonl-a, les couches. — gr. λέχος. Lièker, pl. e, Kr., lac. Lyekoirt, secouer, balancer. Lyekoirtæ, peau, cuir, outre ;*



# Literatura etimologjike

- Schuchardt (1867: 490): < lat. *lacuna* ‘zgavër, pellg’
- Miklosich (1871: 34): < lat. *lacus* ‘liqen’
- Meyer (1891: 234):
  - përzierje e lat. *lacuna* + *lagoena* ‘enë verë’
  - ai përmend dy trajta të tjera: geg. *liqenë* (f.), tosk. *lëqyer* (m.)
- Thumb (1909: 15):
  - *liqenë* (f.) < greq. e vjetër λεκάνη ‘legen’
  - *liqē-ni* (m.) < greq. e vjetër λεκάνιον ‘legen i vogël’
- Jokl (1915: 34):
  - *liqenë* (f.) < greq. e vjetër λεκάνιον
  - *lëqē* “emërore e re” bazohet në interpretimin e formës *liqe-në* si një trajtë në KALL.NJ.SHQ.M
- Çabej (1976-2014, V: 238): < greq. e vjetër λεκάνιον
- Ölberg (1972: 42): < greq. e vjetër λεκάνη, λεκάνιον; ndryshimi ‘legen’ > ‘liqen’ ka ndodhur në shqip
- Orel (1998) nuk e diskutoi fjalën *liqen*
- Topalli (2017: 894):
  - *liqen* < greq. e vjetër λεκάνη
  - prapa-formim i trajtës *liqē-ni* (interpretuar si *liqén-i*); shumësi i singularizuar për të shpjeguar zanoren -e-.

# Përfundimet

- Fjala *liqén-i* < gegërishtja e vjetër *lëqē*, *lëqéni* < \**lëqén*, *lëqéni* < \**lekáni* < greqishtja e hershme mesjetare *λεκάνη* (*lekáni*) ‘det, liqen, pellg’
- Në kohën e tanishme të dixhitalizimit, gjenden shumë gjëra interesante për etimologjinë e shqipes!
- Albanologët e mëdhenj si Meyer, Thumb, Jokl, Çabej, Ölberg etj., bënë hapa shumë të rëndësishëm, por jo gjithmonë kishin të drejtë.
- Ato që kam paraqitur këtu janë gjithashtu vetëm disa hapa drejt zërthimit të historisë aktuale të *liqen-it*.



Universität  
Basel

**Faleminderit për vëmendjen tuaj!**

**A keni pyetje?**

# Referencat

- Çabej, Eqrem (1976-2014). *Studime etimologjike në fushë të shqipës*. Tirana: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë.
- Dozon, Auguste (1879). *Manuel de la Langue Chk'ipe ou Albanaise*. Paris: Ernest Leroux.
- von Hahn, Johann Georg (1854). *Albanesische Studien*. Jena: Friedrich Mauke.
- Jokl, Norbert (1915). Beiträge zur albanesischen Grammatik. In: *Indogermanische Forschungen* 36, 98-164.
- Kristoforidhi, Konstantin (1872a). *Diata e Rë*. Constantinople: A.H. Bojaxhiani.
- Kristoforidhi, Konstantin (1872b). *Abetār Škīp*. Constantinople: A.H. Bojaxhiani.
- Kristoforidhi, Konstantin (1904). *Λεξικόν της αλβανικής γλώσσας*. Athens: Typois P.D. Sakellariou.
- Meyer, Gustav (1883). *Albanesische Studien 1. Die Pluralbildungen der albanesischen Nomina*. Vienna: Akademie der Wissenschaften.
- Meyer, Gustav (1891). *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Strassburg: Karl J. Trübner.
- Miklosich, Franz (1871). *Albanische Forschungen II. Die romanischen Elemente im Albanischen*. Vienna: Akademie der Wissenschaften.
- Ölberg, Hermann. 1972. Griechisch-Albanische Sprachbeziehungen. In: Robert Muth (ed.), *Serta Philologica Aenipontana* 2, 33-64. Innsbruck: Institut für Sprachwissenschaft der Universität.
- Orel, Vladimir (1998). *Albanian Etymological Dictionary*. Leiden, Boston, Köln: Brill.
- Pape, Wilhelm (1842). *Handwörterbuch der griechischen Sprache, Band II: Α-Ω*. Braunschweig: Friedrich Vieweg und Sohn.
- Schuchardt, Hugo (1867). *Der Vokalismus des Vulgärlateins. Zweiter Band*. Leipzig: Teubner.
- Thumb, Albert (1909). Altgriechische Elemente des Albanesischen. In: *Indogermanische Forschungen* 26 Issue 1909 (pp. 1-20).
- Topalli, Kolec (2017). *Fjalor etimologjik i gjuhës Shqipe*. Tirana: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Weigand, Gustav (1914). *Albanesisch-Deutsches und Deutsch-Albanesisches Wörterbuch*. Leipzig: Johann Ambrosius Barth.
- Xylander, Josef (1835). *Die Sprache der Albanesen oder Shkipetaren*. Frankfurt am Main: Andreäische Buchhandlung.